



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 125, Datë 16.08.2017

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË HARMONIZUARA TË ALOKIMIT TË KAPACITETEVE TË INTERKONJEKSIONIT PËR VITIN 2018 PËR ZYRËN E KOORDINIMIT TË ANKANDEVE TË KAPACITETEVE TË INTERKONJEKSIONIT NË EUROPËN JUG-LINDORE (SEE CAO)

Në mbështetje të nenit 16, nenit 30 dhe nenit 65 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; të nenit 51 të Rregullores së Komisionit (BE) 2016/1719, “Për krijimin e një udhëzuesi mbi alokimin e kapaciteteve të ardhshme (Forward Capacity Allocation – FIA)”; nenit 19, pika 1, gërma “f” dhe nenit 26 të “Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin Nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 16.08.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për “*Fillimin e procedurave për Miratimin e Rregullave të Harmonizuara të Alokimit të Kapaciteteve të Interkonjeksionit për vitin 2018 për Zyrën e Koordinimit të Ankandëve të Kapaciteteve të Interkonjeksionit në Evropën Jug-Lindore (SEE CAO)*”, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

Konstatoi se:

- Me shkresën Nr. 4111 Prot, datë 26.07.2017 OST sha, ka paraqitur pranë ERE-s, kërkesën për miratimin e “Rregullave të Harmonizuara të Alokimit të kapaciteteve të interkonjeksionit për vitin 2018 për Zyrën e Koordinimit të Ankandëve të Kapaciteteve të Interkonjeksionit në Evropën Jug-lindore (SEE CAO).
- Operatorët e Sistemit të Transmetimit të SEE dhe Zyra e Koordinuar e Ankandit në Evropën Juglindore (SEE CAO) kanë përgatitur një grup të ri rregullash për të zbatuar Rregullat e Harmonizuara të Alokimit të Kapaciteteve të Interkonjeksionit (referuar si HAR) në rajonin e Evropës Juglindore për procesin e ankandit për vitin 2018.
- Rregullorja është hartuar në përputhje me nenin 51 të Rregullores së Komisionit (BE) 2016/1719, datë 26 Shtator për krijimin e një udhëzuesi mbi alokimin e kapaciteteve të ardhshme (*Forward Capacity Allocation – FIA*).

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e “Rregullave të Harmonizuara të Alokimit të Kapaciteteve të Interkonjeksionit për vitin 2018 për Zyrën e Koordinimit të Ankandëve të Kapaciteteve të Interkonjeksionit në Evropën Jug-Lindore (SEE CAO).
2. Drejtoria e Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, të njoftojë palët e interesuara për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.